



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11.02.2025

Nr: 83

Ora: 15:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV BAZUAR NË DENONCIMIN ME NR. 4 ID, DATË 06.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA/KRIIK

Sot më datë 11.02.2025, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK

SUBJEKT: Zj. Elisa Spiropali
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Z. Engjëll Agaçi
Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave

Palë e interesuar: **Kuvendi i Shqipërisë**
Përfaqësuar nga z. Mimoza Arbi, me detyrë Drejtor i Shërbimit Juridik dhe zj. Elvira Domi me detyrë Këshilltare në Shërbimin Juridik

OBJEKT: Marrja e hapave të nevojshëm për parandalimin e shtrirjeve të efekteve të projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat, të ndryshuar”

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, “n” dhe pika 2, neni 91, pika 4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: 11.02.2025 Nr: 83

Ora: 15:00



“Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 4, datë 06.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK”

KONSTATOJ:

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), më datë 06.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet protokollit, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 4 ID.

Në këtë denoncim KRIIK parashtron sa vijon:

“Në seancën plenare të datës 30 janar 2025, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar me 70 vota pro, projektligjin “Për një shtesë në ligjin 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Nga konsultimi i faqes zyrtare në internet të Presidentit të Republikës si dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare, vërehet se ky projektligj nuk është dekretuar nga Presidenti i RSH dhe as botuar në fletoren zyrtare.”

Me vendimin nr. 73, datë 10.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), u vendos fillimi i procedurës administrative, për shqyrtimin e këtij denoncimi. Bazuar në këtë vendim i'u kërkua personave përgjegjës në Kryeministri dhe në Kuvendin e Shqipërisë për raportimin e veprimtarive publike që të paraqesin prapësimet në lidhje me çështjen objekt hetimi.

Më datë 11.02.2025, KQZ administroi pretendimet e personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Kryeministri, dërguara me e-mail në KQZ. Sipas këtyre pretendimeve:

“Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me shkresën nr.4698/1, datë 26.12.2024, i ka dërguar për mendim Këshillit të Ministrave projektligjin joqeveritar “Për një shtesë në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, propozuar nga një deputet i Kuvendit.

Kjo kërkesë e Kuvendit bazohet në pikën 2, të nenit 82, të Kushtetutës, ku parashikohet.

Projektligji joqeveritar u dërgua për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe ministrin të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

Këshilli i Ministrave vlerësoi pozitivisht iniciativën për këtë projektligj dhe sugjeroi marrjen në konsideratë të mendimeve të ministrive”.

Më datë 11.02.2025, KQZ administroi pretendimet e personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Kuvend, dërguara me e-mail në KQZ. Sipas këtyre pretendimeve:

“Miratimi i ligjit 9/45 “Për një shtesë në ligjin nr. 29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, nuk ka shkelur nenin 91 pika 4 të Kodit Zgjedhor dhe aktet e tjera nënligjore. Natyra e kufizuar e përfituesve, mungesa e efekteve të menjëhershme dhe mungesa e favorizimit elektoral janë faktorë që tregojnë qartë se ky ligj nuk ka qenë një mjet për të fituar përfitime elektorale. Ligji është në përputhje me legjislacionin ekzistues dhe është miratuar në përputhje me procedurat e duhura.”.

Më datë 11.02.2025, ora 15:00, u zhvillua seanca publike për këtë shqyrtim administrativ. Në këtë seancë në cilësinë e përfaqësuesve të Kuvendit u paraqitën zj. Mimoza Arbi, me detyrë Drejtor i Shërbimit Juridik dhe zj. Elvira Domi me detyrë Këshilltare në Shërbimin Juridik pranë Kuvendit, të cilat i qëndruan pretendimeve të depozituara me e-mail në KQZ.

Nga vlerësim të pretendimeve të palëve, fakteve dhe provave të administruara në këtë shqyrtim administrativ çmoj se kërkimi sipas objektit i KRIIK nuk është i mbështetur në ligj.

U provua se, projektligji “Për një shtesë në ligjin 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar, është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 30 Janar 2025.

Gjithashtu u konstatua se, ky projektligj është përcjellë për dekretim te Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në pikën 4, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, ndalimet për propozimin, miratimin ose nxjertjen e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore, janë për ato organe, apo institucione të cilat e kanë kompetencën kushtetuese, apo ligjore për ti miratuar këto akte. Thënë këtë, është e qartë që miratimi i një projektligji është kompetencë kushtetuese e Kuvendit të Shqipërisë dhe jo e Presidetit të Republikës. Sikurse pranohet nga të gjitha palët edhe nga denoncuesi projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar, është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 30 Janar 2025. Në këtë rrethana KQZ, në zbatim të pikën 4, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, nuk mund të disponoj në çfarëdo lloj forme mbi një akt që është miratuar nga organi kompentent (Kuvendi në këtë rast).

Presidenti, bazuar në nenin 93 të Kushtetutës, në këtë rast ka vetëm kompetencën për të dekretuar ligje pas miratimit të tyre nga Kuvendi. Kjo është një kompetencë e tij e ngushtë, që nuk mund të ndalohet ose kufizohet. Ai, Presidenti, në këtë rast nuk është organi miratues i aktit për të cilin bazuar në pikën 4, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, kishte ndalim për miratimin e tij.

Ndaj nuk mund të vijohet me ndalimin e veprimeve të Presidentit të Republikës të Shqipërisë për dekretimin e projektligjit objekt shqyrtimi.

Nxitur nga qëllimi i denoncimit të KRIIK, objekt shqyrtimi i këtij procedimi administrativ, KQZ shqyrtoi projektligjet të cilat janë në kalendarin dhe programin e punës së Kuvendit të Shqipërisë për periudhën nga data 20 Janar deri më datën 28 Shkurt 2025.

Konstatohet se fusha e veprimit të dy projektligjeve, atij “Për paketën e maleve” dhe projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” prekin politika të rëndësishme fiskale.

Ndryshimet e propozuara kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin ekonomik dhe atë tregtar, çdo veprim në këtë drejtim mund të dëmtojë parimin e barazisë mes aktorëve ekonomikë në prag të zgjedhjeve. Ato mund të krijojë perceptimin e përdorimit të mjeteve ligjore për qëllime elektorale.

Kufizimet, apo ndalimet e parashikuara në nenin 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor mund të jenë penguese edhe kur vërehet që akti që kërkohet të shqyrtohet, apo miratohet nuk duket se do të përdoret për qëllime politike, apo elektorale, por është vetë ligjëvënsi ai që në këtë pikë e ka vlerësuar që për një kategori aktesh për periudhën 4 (katër) muaj përpara datës së zgjedhjeve ndalimi për miratimin e tyre është i domosdoshëm. Përrjashtimin e ka bërë vetëm për rastet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, “n” dhe pika 2, nenin 91, pika 4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 4, datë 06.02.2025, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara.
2. T’i rekomandohet Kuvendit të Shqipërisë të mos përfshijë për shqyrtim në seancë plenare projektligjin “Për paketën e maleve” dhe Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI